



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë, më _____. _____. 2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës – Mallra , e hapur mbi kufirin e larte monetar

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti : Blerje kamione per Ndermarrjen e Pastrimit per vitin 2026

Fondi limit : 45,400,000(Dyzetë e pesë milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Leke

Fondi Limit : 484,939 (katërqind e tetëdhjetë e katërmijë e nentëqind e tridhjetë e nente) Euro

Kodi CPV: 42415200-0 - Kamionë pune, 34136200-1 - Kamionçina, 34134200-7 - Kamionë vetëshkarkues,

Tipi i Proçedurës: E hapur mbi kufirin e lartë monetar, Mallra

REF;94240-07-22-2026

Bazuar ne Neni ne 56, te LPP 162/2020, si dhe nenet 12 dhe 24 te VKM per RPP Nr.285 date 19.05.2021, dokumentat e tenderit ne procedurat mbi Kufirin e Larte Monetar vlere e fondit Limit konvertohet ne nje monedhe nderkombetare sipas kursit te Bankes se Shqiperise. (Tek Njoftimi I shkurter qe eshte per tu Publikuar shqip dhe anglisht si dhe ne DST).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar) nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Autoriteti / Enti Kontraktor, Bashkia Vlore, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për proçedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: *"Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik"*.

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 26, nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik të ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

2. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimi/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

1. Vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të lotit**. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, ku përcaktohet se c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme."

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës "Procedurë e hapur të thjeshtuar" edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi sipas përcaktimit të bërë në nenin 43 pika 2 (c) e VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar).

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"

3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitet për keestet e maturuara te vitit 2026 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, neni 5, pika c.

Argumentimi: Ky kriter eshte percaktuar bazuar ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, neni 76 per kriteret detyruese per skualifikim, si dhe Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, I ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 40 % e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore**, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

***Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar duke qënë se vlera e fondit limit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Çertifikate **ISO 9001:2015** “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) **ose ekuivalent**; Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 10 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi. Në rastin e distributorit të autorizuar të paraqitet edhe dokumenti që vërteton se distributori është i autorizuar nga firma prodhuese. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: tel, *fax*, *email*, *website*, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i perkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Autorizimi është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofruesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësor të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmerinë e OE ofrues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben AK për njohjen e mundësisë së OE- së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të ligjit 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të V.K.M Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloge ose skeda teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të mjeteve të ofruara, në mënyrë që të

krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga AK me specifikimet teknike për mjetet e ofruara nga operatori ekonomik.

2.7 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë garancie në të cilën të jenë te përcaktuar dhe përshkruar qartë të gjithë termat dhe kushtet e garancisë teknike që mbulon ofertuesi. Periudha e garancisë teknike do të fillojë nga data e marrjes në dorezim të mjetit nga autoriteti kontraktor dhe të jetë minimumi: 1 (një) vit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallin e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli objekt prokurimi është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të gjitha riparimet dhe shërbimet e përcaktuara në deklaratë do të kryhen te operatori ekonomik kontraktues.

2.8 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, Kategoria VII.3.1 sipas Udhezimit Nr. 1545 datë 29.03.2016, “ Blerje, shitje e mjeteve me motor dhe rimorkjo ose licence ekuivalente sipas legjislacionit në fuqi.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendorsja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallit, objekt prokurimi.

2.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë (zhdoganimin, regjistrimin, targimin me targa shqiptare,etj

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ky kriter është i nevojshëm pasi automjeti objekt prokurimi duhet të dorëzohet në gjendje të rregullt juridike dhe teknike, i pajisur me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për të qenë i gatshëm për qarkullim dhe përdorim të menjëhershëm nga Ndërmarrja e Pastrimit.

Kërkesa për përfshirjen në çmim të procedurave të zhdoganimit, regjistrimit dhe targimit: garanton që Autoriteti Kontraktor të mos ketë kosto shtesë pas lidhjes së kontratës; siguron ekzekutim të plotë dhe funksional të kontratës; shmang vonesat administrative që do të pengonin vënien në përdorim të mjetit; garanton që mjeti të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe teknike për qarkullim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ky kriter vlerësohet proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, pasi lidhet me funksionalitetin dhe përdorimin efektiv të automjetit që do të vihet në shërbim të ndërmarrjes. Për më tepër, ai është në përputhje me parimet e eficiencës, efektivitetit dhe mirëadministrimit të fondeve publike, duke garantuar që Autoriteti Kontraktor të marrë në dorëzim një mjet plotësisht funksional dhe të gatshëm për përdorim.

2.10 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjetet janë prodhuar në vendet e Bashkimit Europian ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset për të garantuar që automjetet:

- janë në përputhje me standarde të njohura ndërkombëtarisht të cilësisë, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- mund të regjistrohen dhe të përdoren pa pengesa, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- sigurojnë besueshmëri në funksionim, disponueshmëri të pjesëve të këmbimit dhe mundësi për mirëmbajtje sipas standardeve të prodhuesit;
- ulin kostot operative dhe ndikimin në mjedis gjatë gjithë ciklit të përdorimit të automjetit.

Kërkesa nuk lidhet domosdoshmërisht me vendin e prodhimit ose origjinën e automjetit, por vetëm me përmbushjen e standardeve teknike dhe dokumentimin e përputhshmërisë së tij. Për këtë arsye, ajo respekton parimet e trajtimit të barabartë, duke siguruar njëkohësisht që nevojat funksionale të Autoritetit Kontraktor të përmbushen me automjete që garantojnë cilësi, siguri dhe performancë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe kriteret e kualifikimit janë të hartuara nga Grupi i Punës, në përputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të ligjit nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Shënim: Në çdo rast kur në specifikimet teknike mund të jetë e përdorur si referenecë emri i ndonjë marke apo emri të veçante, patente, vizatim ose tip ose origjine ose prodhim specifik, përfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN MINI NGARKUES ME GOMA

Kërkohet makineri e prodhuar jo më herët se viti 2026 për të garantuar përdorimin e teknologjive më të fundit, besueshmëri të lartë, efikasitet energjetik dhe jetëgjatësi maksimale.

Makineria do të jetë pjesë e flotës së ndërmarrjes për shumë vite, ndaj është e domosdoshme që të ketë mbështetje afatgjatë me pjesë këmbimi dhe shërbim teknik.

Makineria do të përdoret çdo ditë në shërbimet e pastrimit urban. Furnizimi me një pajisje të re eliminon rrezikun e defekteve të trashëguara, redukton kostot e mirëmbajtjes dhe garanton siguri e disponueshmëri të lartë operative. Motori me naftë siguron çift rrotullues të lartë, konsum ekonomik dhe performancë të qëndrueshme gjatë punës intensive. Gjithashtu, është në përputhje me sistemin ekzistues të furnizimit me karburant të ndërmarrjes. Fuqia minimale prej 55 kW është e nevojshme për të përballuar ngarkimin e materialeve të ndryshme, pastrimin e depozitimeve të mbetjeve, transportin e dheut dhe inerteve, si dhe përdorimin e pajisjeve shtesë hidraulike. Një fuqi më e ulët do të kufizonte produktivitetin dhe aftësinë e makinerisë për të punuar në kushte të vështira.

Makineria do të operojë kryesisht në zona urbane. Kërkesa për motor me standard minimal Stage III/Tier III synon uljen e emetimeve ndotëse, reduktimin e konsumit të karburantit dhe respektimin e kërkesave mjedisore gjatë ofrimit të shërbimeve publike.

Pesha minimale 3500 kg garanton stabilitet gjatë ngritjes dhe transportimit të materialeve, përmirëson tërheqjen në terrene të ndryshme dhe rrit sigurinë gjatë manovrimeve. Një makineri më e lehtë do të kishte kapacitete më të kufizuara pune.

Kapaciteti minimal i përmbysjes prej 2400 kg garanton ngritjen dhe transportimin në mënyrë të sigurt të ngarkesave të zakonshme që hasen gjatë pastrimit të qytetit, si materiale inerte, mbetje ndërtimore, dheut dhe materiale të tjera. Kjo vlerë siguron edhe rezervë sigurie gjatë operimit. Prurja minimale prej 90 l/min është e nevojshme për funksionimin efikas të sistemit hidraulik dhe të pajisjeve shtesë, si furça pastrimi, kovat speciale apo pajisje të tjera që mund të përdoren nga ndërmarrja në të ardhmen. Gjithashtu siguron cikle pune më të shpejta dhe produktivitet më të lartë.

Transmisioni hidrostatik ofron kontroll të saktë të shpejtësisë, manovrim të lehtë dhe ndryshim të menjëhershëm të drejtimit të lëvizjes. Ky sistem është veçanërisht i përshtatshëm për punë në rrugë të ngushta, trotuare, parqe dhe ambiente urbane.

Komandimi elektronik përmirëson saktësinë e lëvizjeve, ul lodhjen e operatorit dhe rrit produktivitetin gjatë punës së vazhdueshme. Gjithashtu mundëson kontroll më të mirë të pajisjeve hidraulike dhe rrit sigurinë gjatë operimit.

Kova standarde është pajisja bazë me funksionale për kryerjen e punimeve të përditshme të ndërmarrjes, si ngarkimi i dheut, inerteve, mbetjeve të ndryshme dhe materialeve të mirëmbajtjes. Ajo siguron fleksibilitet dhe mund të përdoret në shumicën e operacioneve komunale.

Dimensionet kompakte lejojnë operimin në rrugë të ngushta, trotuare, sheshe publike, tregje dhe ambiente të kufizuara, ku makineritë më të mëdha nuk mund të punojnë me efikasitet.

Lartësia e kufizuar mundëson hyrjen dhe punën në ambiente të mbuluara, magazina, parkingje dhe hapësira të tjera urbane me kufizime lartësie, duke rritur fleksibilitetin e përdorimit të makinerisë.

Sistemi Seat Bar është një element thelbësor sigurie që parandalon aktivizimin aksidental të komandave dhe mbron operatorin gjatë punës. Ai redukton rrezikun e aksidenteve dhe është standard në makineritë moderne të kësaj kategorie.

Kabina e mbyllur mbron operatorin nga pluhuri, reshjet atmosferike, temperaturat ekstreme dhe zhurma, duke krijuar kushte të përshtatshme pune gjatë gjithë vitit dhe duke rritur sigurinë gjatë operimit.

Makineria do të përdoret në të gjitha stinët dhe për periudha të gjata pune. Sistemi i kondicionimit siguron temperaturë të përshtatshme në kabinë, redukton lodhjen e operatorit dhe ndikon pozitivisht në produktivitet dhe sigurinë në punë.

Sedilja me amortizim redukton dridhjet e transmetuara te operatori gjatë lëvizjes në terrene të pabarabarta, përmirëson ergonominë dhe ul lodhjen gjatë turneve të gjata të punës.

Dritat e punës mundësojnë përdorimin e sigurt të makinerisë në kushte me ndriçim të kufizuar, gjatë ndërhyrjeve emergjente ose në orët e para dhe të fundit të ditës.

Alarmi akustik gjatë lëvizjes mbrapa rrit sigurinë e punonjësve dhe kalimtarëve në zonat urbane, ku makineria operon shpesh pranë mjeteve dhe këmbësorëve.

Ndriçimi LED ofron intensitet më të lartë ndriçimi, konsum më të ulët energjie dhe jetëgjatësi më të madhe krahasuar me sistemet tradicionale, duke garantuar punë të sigurt edhe në kushte me dukshmëri të kufizuar.

Paneli elektronik monitoron në kohë reale parametrat kryesorë të makinerisë, si temperatura e motorit, presioni i vajit, niveli i karburantit, intervalet e mirëmbajtjes dhe sinjalizimet e defekteve. Kjo ndihmon në parandalimin e avarive dhe ul kostot e mirëmbajtjes.

Kova standarde përfaqëson konfigurimin bazë të domosdoshëm për realizimin e shumicës së operacioneve të përditshme të ndërmarrjes, duke ofruar fleksibilitet për ngarkimin dhe transportimin e materialeve të ndryshme.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR MJETIN SKREP ME KOVË PARA DHE PAS

Kërkesa për vitin e prodhimit min. 2025 garanton furnizimin me një mjet të prodhuar sipas teknologjive më të fundit, me efikasitet më të lartë operacional, konsum më të ulët karburanti dhe jetëgjatësi më të madhe. Gjithashtu siguron disponueshmërinë e pjesëve të këmbimit dhe mbështetjes teknike nga prodhuesi për shumë vite.

Mjeti do të punojë çdo ditë në kushte të rënda pune, ndaj duhet të jetë i ri për të garantuar eliminimin e defekteve të trashëguara, uljen e kostove të mirëmbajtjes dhe jetëgjatësi të plotë të komponentëve mekanikë dhe hidraulikë.

Motorët me naftë ofrojnë çift rrotullues të lartë në regjim të ulët pune, karakteristikë e domosdoshme për ngarkimin e mjetëve të ndryshme.

Një fuqi minimale prej 70 kW siguron kapacitet të mjaftueshëm për kryerjen njëkohësisht të largimit të mjetëve të depozituara në mënyrë të paligjshme, ngarkimi i dheut dhe inerteve etj.

Fuqia më e ulët do të ulte ndjeshëm produktivitetin dhe do të rriste konsumin për njësi pune.

Standardi Tier III garanton ulje të ndotjes atmosferike, konsum më të ulët karburanti, respektim të kërkesave mjedisore. Ky standard është i përshtatshëm për kushtet operative të ndërmarrjes.

Punimet e pastrimit kërkojnë ndërrime shumë të shpeshta të drejtimit përpara-prapa.

Transmisioni Heavy Duty Powershift mundëson ndryshim marshesh pa ndërprerje të fuqisë, rrit produktivitetin, ul konsumimin e transmetimit dhe përmirëson manovrimin në hapësira të kufizuara.

Pesha operative garanton balancim gjatë ngritjes së ngarkesave, forcë më të madhe shtytëse dhe siguri gjatë punës në terrene të pabarabarta.

Një mjet më i lehtë do të kishte stabilitet më të kufizuar.

Kapaciteti prej të paktën 1.1 m³ lejon ngarkimin e inerteve dhe mbetjeve. Kjo rrit ndjeshëm produktivitetin dhe ul numrin e cikleve të ngarkimit.

Lartësia e shkarkimit: Minimum 2.75 m lejon ngarkimin e kamionëve.

Gjithashtu garanton shkarkim pa pengesa mbi bordurat e mjeteve.

Forca thyese e kovës së ngarkimit: Minimum 7 700 kg është e nevojshme për depërtim në materiale të ngjeshura si mbetje të kompaktuara

Forca më e ulët do të ulte efikasitetin e ngarkimit.

Kapaciteti i ngarkesës së kovës para Minimum 3 000 kg garanton që mjeti do të përballojë pastrimin e inerteve dhe mbetjeve të rënda me një numër më të ulët ciklesh dhe pa mbingarkuar systemin hidraulik.

Ky kapacitet është optimal për hapje gropash për pemët dhe pastrime të ndryshme në vendë me hapësirë të kufizuar.

Thellësia e gërmimit: Minimum 4 700 mm lejon pastrimin e mbetjeve në hapësira shumë të kufizuara.

Rrezja e punës 5500 mm lejon punë pa lëvizur vazhdimisht mjetin, rritje të produktivitetit dhe ndërhyrje në zona të vështira.

është e domosdoshme për depërtim në tokë të forte, gurë të vegjël, mbetje të konsoliduara.

Siguron efikasitet të lartë gjatë gërmimeve.

Presioni i pompës hidraulike: Minimum 240 bar

Presioni hidraulik garanton forcë të lartë ngritëse, reagim të shpejtë të cilindrave, punë të vazhdueshme pa humbje performance dhe funksionim normal të të gjitha pajisjeve hidraulike.

Një prurje prej të paktën 140 l/min siguron lëvizje të shpejtë të krahëve, cikle më të shpejta pune, produktivitet më të lartë dhe mundësi përdorimi të aksesorëve hidraulikë.

Kontrolli me joystick rrit saktësinë e manovrimit, ul lodhjen e operatorit, përmirëson sigurinë dhe rrit produktivitetin gjatë punës shumëorëshe.

Është tashmë standard në makineritë moderne.

Sistem AC, radio, ekran LCD, port USB përmirësojnë kushtet e punës së operatorit ku klima ruan temperaturën optimale gjatë sezonit veror dhe dimëror, ekrani LCD monitoron parametrat e funksionimit të motorit dhe sistemit hidraulik, radio dhe porta USB përmirësojnë ergonominë gjatë punës së zgjatur.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

